



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45 regjistër (JR)
Datë 12.10.2023

Nr. 3 i vendimit
Datë 15.01.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e enjte, datë 15.01.2026, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretare gjyqësore Arjela Vilaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 45/2023 (JR), që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florjan Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, z. Klodjan Braho, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 682, datë 10.07.2023, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini, që përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini, i deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 682, datë 10.07.2023, lidhur me të tri kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit:
 - Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
 - Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
 - Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.
4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni, me vendimin nr. 682, datë 10.07.2023, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

III. Ankimi i Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit, pasi ka çmuar se ai përmban shkaqe ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik adresohen në drejtim të pamjaftueshmërisë financiare për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 53,5 m², në Tiranë, në vlerësim tërësor me kontradiktat e deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe me aspektet e fiktivitetit që referohen në hartimin e praktikës dokumentare të kalimit të pronësisë së këtij apartamenti. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik vlerëson se nisur nga referimi i agjencive ligjzbatuese, organe ndihmëse në kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, dy procedime penale, objekt hetimi administrativ nga Komisioni, nuk janë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të gjithanshme, për të përjashtuar eventualitetin e gjendjes së subjektit të rivlerësimit në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar dhe disa çështje në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, lidhur me përdorimin e dy automjeteve nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për dy denoncime të publikut.
6. Në përfundim, bazuar në nenet Ç, D, E dhe F, të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka kërkuar që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Komisioneri Publik legjitimohet dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve.
10. Në seancën gjyqësore publike të datës 04.12.2025, trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Altin Dumani, i cili u përfaqësua në gjykim nga z. Klodjan Braho, sipas tagrave të përfaqësimit të pasqyruara në autorizimin nr. {***} prot., datë 27.11.2025.
11. Në këtë seancë, në parashtrimet e tij përpara Kolegjit lidhur me ankimin, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, deklaroi se u qëndron shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit, pasi, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.
12. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të parashtrimeve lidhur me ankimin, kërkoi mospranimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, si një vendim i mbështetur në një shqyrtim të drejtë dhe në përputhje me standardet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Së bashku me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore, të cilat kërkoi të merren nga Kolegji në cilësinë e provave të reja në proces nëpërmjet çeljes së hetimit gjyqësor, me qëllim shqyrtimin e plotë të rrethanave faktike që lidhen me vlerësimin e të tri kritereve.
13. Në përfundim të kësaj seance, trupi gjykues, pasi dëgjoi kërkimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me çështjen dhe aktet, në bazë të nenit F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1, shkronja “a” të ligjit 84/2016 “, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes, duke marrë në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur parashtrimeve dhe ato të sjella në seancë. Lidhur me kontrollin e figurës, trupi gjykues vendosi të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me informacionin e klasifikuar të njohur nga Komisioni në kuadër të çështjes, pranë institucioneve ligjzbatuese që e administrojnë atë.
14. Në seancën publike të datës 12.01.2026, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për kriterin e pasurisë, vlerësoi bindëse deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket vlerës së pasurisë apartament me sip. 53,5 m², në Tiranë dhe burimeve të krijimit të saj, duke konkluduar se problematikat e konstatuara në lidhje me këtë pasuri nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Për çështjet e trajtuara lidhur me kontrollin e figurës dhe gjetjet në raportin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bazuar në shpjegimet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në vlerësim të informacioneve të klasifikuara të aksesuara drejtpërdrejt prej tij, duke pasur në konsideratë vlerën burimore dhe saktësinë e tyre, si dhe rrethanën se nuk rezulton asnjë e dhënë për veprime korruptive apo në kundërshtim me detyrën të subjektit të rivlerësimit, çmoi se nuk ka shkaqe që të justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra. Për çështjet e trajtuara lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të të tri kritereve, Drejtuesi i

Prokurorisë së Posaçme vlerësoi të shëruara shkaqet e ankimit lidhur me dy automjetet në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, pas shpjegimeve dhe akteve shkresore të paraqitura prej tij, ndërsa për denoncimet e shtetasve E. Gj. dhe H. Sh. konkludoi se të metat e konstatuara nuk kanë peshë të tillë për të afektuar vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

15. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave të administruara dhe të konfirmuara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje në Kolegj, i kërkoi trupit gjykues lënien në fuqi të vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini.
16. Bazuar në këto fakte juridike të natyrës procedurale, pasi vërejti se ankuesi, gjatë gjykimit të çështjes, ndryshoi kërkimin e parashtruar fillimisht në ankim, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji që vendimi i kundërshtuar nëpërmjet ankimit të lihet në fuqi, trupi gjykues vlerësoi si thelbësore për zgjidhjen e çështjes përcaktimin e pasojës juridike procedurale të këtij kërkimi.
17. Në kuadër të kësaj analize, në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik, ka disponuar deri në përfundim të mandatit të tij kushtetues, në mënyrë të plotë dhe të pavarur të drejtën e ushtrimit të ankimit kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, si pasojë e mbarimit të mandatit kushtetues të këtij institucioni dhe kalimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, rrjedhimisht ky i fundit tashmë gëzon në mënyrë ekskluzive edhe të drejtën e disponimit mbi ankimet e ushtruara prej Komisionerit Publik.
18. Trupi gjykues vëren se ankimi është një mjet procedural nëpërmjet të cilit ankuesi, në mbrojtje të interesit publik, kundërshton mbi bazë faktike dhe ligjore drejtësinë e vendimit të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i mjetit procedural të ankimit, ka kërkuar para Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, konkludohet se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimit, duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt. Kjo situatë përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, dhe trupi gjykues vlerëson se gjendet para zbatimit të detyrueshëm të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet dhe rregullohet pasoja ligjore e heqjes dorë nga ankimi, sipas këtij përcaktimi: *Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.*
19. Për sa më sipër, në vlerësim të trupit gjykues nuk ka më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt shqyrtimi, për sa kohë ankimi ka humbur objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për këtë situatë faktike procedurale është pushimi i shqyrtimit në Kolegj i çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 45/2023, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini, pasi vijimi i gjykimit për kontrollin e vendimit të Komisionit, mbi bazën e një ankimi të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të procesit të rregullt ligjor.

20. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, trupi gjykues i Kolegjit gjen të nevojshëm të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, objekt i ankimit të Komisionerit Publik. Në këtë kuptim, trupi gjykues konstaton se në zbatim të parashikimeve të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, neneve 1, pika 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe neneve 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 682, datë 10.07.2023, i Komisionit, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.
21. Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se për shkak të heqjes dorë nga ankimi prej ankuesit shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 45, datë 12.10.2023, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.01.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues së çështjes nr. 45/2023 (JR), jam kundër vendimit nr. 3, datë 15.01.2026, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *“Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 45, datë 12.10.2023, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 682, datë 10.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini”*.
2. Në vijim të qëndrimit të mbajtur në vendimet pararendëse, në të cilat Komisioneri Publik/Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, procedurën e ndjekur nga shumica e trupit gjykues e konsideroj të padrejtë dhe në kapërcim të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes në fjalë. Arsyetimin tim e mbështes në legjislacionin e zbatueshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar, si vijon.
 - 2.1. Referuar parashikimit në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”*, jo pa qëllim, ligjvënësi nuk orienton në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të aplikuara nga shumica për pushimin e shqyrtimit të çështjes, por është kujdesur të përcaktojë dispozitat e aplikueshme në këtë proces, ato që normojnë procesin administrativ. Përcaktim, i cili vjen në harmoni dhe me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, se: *“Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’”*.
 - 2.2. Neni 64, pika 4 e Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin orienton drejtpërdrejt ligji nr. 84/2016, përcakton se: *“Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”*.
 - 2.3. Për analogji, gjen zbatim edhe neni 31/b, pika 2 e ligjit organik nr. 8577, datë 10.02.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa, kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik [...]”*.
3. Në vlerësimin tim, arsyetimi i përdorur në vendim nga shumica e trupit gjykues dhe vendimmarrja e tyre nuk mbështetet në ligj, si dhe bie në kundërshtim me kompetencat që i njeh Kushtetuta dhe ligji Kolegjit. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në cilësinë e ankuesit, në përfundim të gjykimit sipas bindjes së tij, mund të kërkojë secilën alternativë të parashikuar në ligj, por trupi gjykues i Kolegjit, në rastin konkret, nuk duhet të vendosë pushimin e gjykimit, duke e konsideruar në thelb situatën *një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi*, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile.
4. Kërkimi për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme përbën një qëndrim mbi themelin e çështjes dhe nuk mund të passjellë të njëjtin efekt procedural me atë të heqjes dorë nga ankimi, sikurse ka vlerësuar shumica e trupit gjykues. Në

mungesë të një deklarami të qartë dhe të shprehur për tërheqje, nuk mund të konkludohet nga Kolegji se pala ka hequr dorë nga e drejta e saj procedurale e ankimit. Për pasojë, këto dy institute nuk mund të barazohen, as në koncept dhe as në efekt, pasi prodhojnë pasoja juridike të ndryshme. Barazimi tyre, në vlerësimin tim, do të cenonte të drejtën për një proces të rregullt, si dhe do të krijonte paqartësi në interpretim të vullnetit të palëve. Në zbatim të ligjit dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit, çmoj se shumica e trupit gjykues duhet ta shqyrtonte çështjen në themel mbi bazë të parimeve për një proces të rregullt ligjor, pavarësisht kërimit të paraqitur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare dhe, në përfundim, të vendoste sipas alternativave të parashikuara nga neni 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

5. Sa më sipër, Kolegji, si gjykata e vetme e këtij procesi, nuk duhet të shmangë kompetencat kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik e, për këto arsye, si gjyqtare në pakicë, çmoj se trupi gjykues duhet të vijonte me shqyrtimin e çështjes, deri në zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi